

Nr. prot. \_\_\_\_\_

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

13.03.2024

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: "ERA a.s" me nr. identifikimi CZ 60916427.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetarë.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-92512-12-29-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **"Implement MLAT për Tirana dhe Vlora TMA"** me fond limit **250,000,000** (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë pa tvsh, ose 2,406,623 (Dy milion e katërqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e njëzetë e tre) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 29/12/2023 është 103.88 Lekë/Euro. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike *nuk ka*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Operatorët Ekonomik të mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "Radio Frequency & Advance Engineering sh.p.k. me NIPT L11629005K dhe Thales Italia S.p.A" me nr. identifikimi IT05712031003.

- Çmimi i ofertës: 187 751 105.82 (Njëqind e tetëdhjetë e shtatëmilion e shtatëqind e pesëdhjetë e njëmijë e njëqind e pesë e tetëdhjetë e dy të qindat) lekë pa tvsh.

2. Operatori Ekonomik: "ERA a.s" me nr. identifikimi CZ 60916427.

- Çmimi i ofertës: 219 660 493 (Dyqind e nëntëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre) ose 2 114 560 (Dy milion e njëqind e katërmëdhjetëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) Euro pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "Radio Frequency & Advance Engineering sh.p.k. me NIPT L11629005K dhe Thales Italia S.p.A" me nr. identifikimi IT05712031003.

**Arsyeja:** Autoriteti Kontraktor, ne Dokumentat Standarte te Tenderit, shtojca 8 "Kriteret e perzgjedhjes / kualifikimit", pika 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 2.2.1 e Kapacitetit ekonomik dhe financiar ka kerkuar qe:

**2.2.1** *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare*

*(2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.*

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “Radio Frequency & Advance Engineering dhe Thales Italia S.p.A”, kanë nënshkruar marrveshje bashkëpunimi të datës 22.02.2024. OE, Radio Frequency & Advance Engeniering sh.p.k, ka të përcaktuar ndarjen e aktiviteteve në kuoten 30%, dhe Thales Italia S.p.A 70 % .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në Kreun XI, Nenit 88, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nga verifikimi i vertetimit të xhiros me datë, 21.02.2024 paraqitur nga OE, Radio Frequency & Advance Engeniering sh.p.k, rezulon që nuk permbushet ky kriter për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar 2020,2021,2022.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: “ERA a.s” me nr. identifikimi CZ 60916427, me adresë: Prumyslova 462, 53 03 Pardubice, The Czech Republic, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 219 660 493 (Dyqind e nëntëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e tre) ose 2 114 560 (Dy milion e njëqind e katërmbëdhjetëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) Euro pa tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
LAURETA OMERI**